

Vendim nr. 202 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Sonila Bejtja, Anëtare
Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERMAL ALLA

OBJEKTI: Saktësim dhe plotësim i vendimit nr. 149, datë 28.06.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar (*ligji nr. 8454/1999*) ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Avokatit të Popullit (*neni 1*). Ai, gjithashtu, parashikon detyrat e këtij të fundit në drejtim të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme

e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj (neni 2, pika 1). Në kreun III të ligjit rregullohen ankesat, rregullat e shqyrtimit të çështjeve dhe kompetencat e Avokatit të Popullit në këtë drejtim. Sipas nenit 12, çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të ligjshëm nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur, kurse në nenin 14 parashikohen kushtet e pranimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve. Ankesat, kërkesat dhe njoftimet nuk kërkojnë ndonjë formë të caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës dhe çdo shërbim që bëhet nga Avokati i Popullit në këtë drejtim është pa pagesë (nenet 15 dhe 16 të ligjit). Neni 17 i ligjit, që rregullon administrimin e ankesave ose njoftimeve, parashikon se Avokati i Popullit, pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, vendos: a) ta pranojë ose jo çështjen për shqyrtim; b) t'i kthejë përgjigje të interesuarit, duke i treguar të drejtat dhe rrugët nëpërmjet të cilave ai mund ta mbrojë këtë të drejtë; c) t'ia kalojë çështjen organit kompetent, si dhe, në të gjitha këto raste, ai njofton të interesuarit brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës, kërkesës ose njoftimit.

2. Me ankesën e datës 12.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Avokatit të Popullit për të ndërhyrë për sqarimin e situatës së tij në lidhje me mosveprimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në kthimin e përgjigjes ndaj aplikimit të kërkuesit përmes sistemit *e-Albania*. Në ankesë është pretenduar se ASHK-ja nuk zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative (KPA), të cilat rivendosin të drejtat kushtetuese dhe ligjore të kërkuesit të cenuara nga regjistrimi i aktit noterial. Sipas ankesës drejtuar Avokatit të Popullit, edhe pse në listën e shërbimeve që ofron ASHK-ja rasti i kërkuesit nuk është i parashikuar, kjo nuk përjashton detyrimin e atij organi publik për të zbatuar dispozitat e KPA-së.

3. Me shkresën nr. K 3/E 4-2 prot., datë 21.03.2024, Avokati i Popullit, bazuar në nenin 17, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454/1999, ka rekomanduar kërkuesin që fillimisht të konsumojë rrugën e ankimit administrativ, sipas nenit 65 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për kadastrën”, duke ushtruar ankim në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së. Sipas Avokatit të Popullit, referuar objektit të ankesës, njëra nga problematikat e ngritura, ajo për mungesën e parashikimit të rastit të kërkuesit në listën e shërbimeve që ofron ASHK-ja, është e tillë që duhet sjellë fillimisht në vëmendjen e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

4. Me kërkesën e datës 26.04.2024, përmes shërbimit postar, kërkuesi Ermal Alla i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

5. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 149, datë 28.06.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të legjitimitit të kërkuetit. Sipas Kolegjit, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ka arritur të provojë pasojat e drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij kushtetuese për shkak të përmbajtjes së dispozitës së kundërshtuar, ndaj nuk mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes për sa kohë nuk provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

6. Me kërkesën e datës 02.08.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga ana e Kolegjit është keqinterpretuar kërkesa e tij, e cila ka objekt të qartë dhe arsyetim të kuptueshëm, për sa kohë ai ka kërkuar shfuqizimin e nenit 17 të ligjit nr. 8454/1999 për faktin se në shkronjën “a” të tij nuk përcakton kriteret dhe mënyrat se kur është rasti të pranojë çështjen (ankesën) për shqyrtim ose të mos e pranojë atë, çka bie në kundërshtim me nenin 12 të po këtij ligji dhe me të drejtën kushtetuese që i jep dhe garanton neni 60, pika 1, i Kushtetutës për t`u mbrojtur nga abuzimet e organeve publike.

III

Vlerësimi i Kolegjit

8. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, rregullat e detajuara të procedurave të gjykimit kushtetues përcaktohen nga ligji nr. 8577/2000 dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës

Kushtetuese (*Rregullorja*), të cilat kanë parashikuar në dispozita të posaçme edhe kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjykimit kushtetues. Në kuptim të këtyre parashikimeve, një prej rasteve në të cilin mund të vihet në lëvizje Gjykata për të shqyrtuar vendimmarrjet e saj, është kur kërkohet saktësimi dhe plotësimi i vendimit me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80 i ligjit nr. 8577/2000*). Ky parashikim është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohen, por veçse mund të saktësohen, plotësohen ose ndreqen gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në to.

9. Kërkuesi Ermal Alla, pasi është njohur me vendimin nr. 149, datë 28.06.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese ka paraqitur kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e tij, duke pretenduar se kërkesa e tij e datës 26.04.2024, për të cilën është vendosur mospranimi për shqyrtim në seancë plenare, ka objekt të qartë dhe arsyetim të kuptueshëm, për sa kohë është kërkuar shfuqizimi i nenit 17 të ligjit nr. 8454/1999 për faktin se në shkronjën “a” të tij nuk përcakton kriteret dhe mënyrat se kur është rasti të pranojë çështjen (ankesën) për shqyrtim ose të mos e pranojë atë, çka bie në kundërshtim me nenin 12 të po këtij ligji dhe me të drejtën kushtetuese që kërkuesit ia jep dhe garanton neni 60, pika 1, i Kushtetutës për t`u mbrojtur nga abuzimet e organeve publike.

10. Kolegji, referuar shkaqeve të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi, vëren se ato kanë të bëjnë me mënyrën se si janë vlerësuar nga Kolegji i Gjykatës pretendimet e parashtruara në kërkesën e mëparshme të paraqitur prej tij, e datës 26.04.2024, pra nuk kanë të bëjnë me asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 43 të Rregullores, pra për gabime në shkrim, në llogari ose pasaktësi në vendimin nr. 149, datë 28.06.2024 të Kolegjit të Gjykatës. Për rrjedhojë, për sa kohë që pretendimet e kërkuesit janë përsëritje e pretendimeve të paraqitura më parë prej tij përpara Gjykatës, mënyra se si Kolegji i ka vlerësuar ato nuk mund të vihet në diskutim apo të bëhet objekt kontrolli i kësaj Gjykate.

11. Për sa më sipër, për sa kohë vendimet e kësaj Gjykate nuk mund të bëhen objekt kontrolli ose rishikimi as nga vetë ajo, përveç rasteve të përcaktuara, në këtë rast, në mënyrë të shprehur në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000, dhe në kushtet kur kërkuesi nuk ka argumentuar se ndodhet përpara ndonjërit prej këtyre rasteve, Kolegji vlerëson se ai nuk legjitimohet t`i drejtohet Gjykatës me kërkesën në shqyrtim.

12. Po kështu, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje të kërkuarit se paraqitja e kërkesave të tilla, për të njëjtat shkaqe dhe në thelb edhe për të njëjtin objekt, përbën premisë për zbatimin e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, që parashikon mundësinë e vendosjes së gjobës për abuzim me të drejtën për të paraqitur kërkesë.

13. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.